

Serwer: Formimi i institucioneve në Kosovë kërkon kompromise FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

PROCESI NDAJ KATËR ISH-KRERËVE TË UÇK-së PO I AFROHET FUNDIT.

FAQE 4-5



Pas më shumë se tre vjetësh gjykim, procesi ndaj katër ish-krerëve të UÇK-së po i afrohet fundit. Sipas njohësve të

drejtësisë ndërkombëtare dhe Ballkanit, aktgjykimi nuk do të jetë vetëm një përgjigje për përgjegjësinë penale të të

akuzuarve. Ai mund të ndikojë edhe në mënyrën se si do të lexohet lufta e Kosovës dhe trashëgimia e saj në vitet që vijnë

RCC: EVROPA NUK MUND T'I LEJOJË VETES ÇËSHITJE TË PAPËRFUNDUARA NË GJASHTË VENDET E BALLKANIT PERËNDIMOR F. 3



PROTESTOHET EDHE NË KROACI PËR ISH-KRERËT E UÇK-së: 'LIRI PËR ÇLIRIMTARËT' F. 5



BIE NUMRI I NDËRMARRJEVE TË REGJISTRUARA NË MAJ KRAHASUAR ME NJË VIT MË PARË F. 8

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
E-mail: renova@mt.net.mk
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 735
Fax: +389 44 487 200
Mok: +377 44 501 289

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVIÇË

SPORT



SUNDERLANDI REFUZOI OFERTËN PREJ 8 MILIONË EUROSH, CHELSEA PËRGATIT OFERTËN E RADHËS PËR GRANIT XHAKËN F. 24

Kolegji BIZNESI
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
030 500 870 | 045 500 870
044 500 870 | 049 500 870

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANJIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

OBSH: VAPA EKSTREME MUND TË KETË SHKAKTUAR MBI 1.300 VDEKJE SHITESË NË EVROPË

BERLIN, 29 QERSHOR - Kreu i Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSH), Tedros Adhanom Ghebreyesus, paralajmëroi se temperaturat ekstreme mund të jenë përgjegjëse për qindra vdekje shtesë në Evropë. “Mbi 1.300 vdekje shtesë janë regjistruar që nga 21 qershori dhe lidhen me temperaturat e larta në Evropë”, shkroi Tedros në rrjetin X. “Evropa është kontinenti që po ngrohet më shpejt në botë, me ritëm dy herë më të lartë se mesatarja globale. Aktualisht, 150 milionë njerëz jetojnë nën ndikimin e vapës ekstreme - qindra kanë humbur jetën, shkollat janë mbyllur dhe rrjetet energjetike po mbingarkohen”, shtoi ai, raporton Rel.

Gjatë fundjavës së shkuar, në disa vende evropiane, përfshirë Gjermaninë, Poloninë dhe Çekinë, janë thyer rekordet e temperaturave, duke arritur ose tejkaluar 40 gradë Celsius. Autoritetet çeke u bënë thirrje qytetarëve të shmangin

aktivitetin fizik dhe lëshuan paralajmërime për smog në pjesën qendrore dhe veriore të vendit, për shkak të niveleve të larta të ozonit pranë sipërfaqes së tokës, të shkaktuara nga vapa.

Në Gjermani u reduktuan udhëtimet me tren në një linjë kryesore në landin perëndimor, Nordrhajn-Vestfalenit, ndërsa në qytetin lindor të Lajpcigut u pezullua qarkullimi i tramvajeve.

Policia e Berlinit përdori topa uji për t'i ndihmuar banorët e kryeqytetit të freskoheshin. Sipas mediave lokale, shumë njerëz qëndruan brenda në shtëpi dhe shmangën daljet jashtë deri pas perëndimit të diellit.

Kompania franceze e shpërndarjes së energjisë, Enedis, njoftoi të dielën pasdite se rreth 36.000 familje në veri dhe në qendër të Francës kanë mbetur pa energji elektrike.

Qeveria e Hungarisë tha se centrali bërthamor Paks në këtë



vend, ka ulur prodhimin të dielën, për shkak të temperaturës së lartë të lumit Danub - uji i të cilit përdoret për ftohje.

Tedros tha se stresi nga nxehtësia, shpesh quhet “vrasës i heshtur”, duke shtuar se

shtëpitë, vendet e punës dhe shkollat në Evropë nuk janë ndërtuar për të përballuar temperatura të tilla. “I nxitur nga ndryshimet klimatike dhe ngrohja globale, fenomeni i valëve të të nxehtit që dikur ndodhte një herë në një brez,

tani po përsëritet pothuajse çdo vit”, tha ai.

Agjencia e lajmeve, Reuters, citoi disa shkencëtarë të kenë thënë se vala e të nxehtit, e cila nisi më 20 qershor, ka qenë më e rënda e regjistruar ndonjëherë në Evropë.

SHBA-ja DHE IRANI JANË PAJTUAR T'I NDALIN SULMET DHE T'I RIFILLOJNË NEGOCIATAT, THOTË NJË ZYRTAR

WASHINGTON, 29 QERSHOR - Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Irani kanë rënë dakord të ndalin sulmet hakmarrëse ndaj njëri-tjetrit dhe të takohen sërish për negociata, duke lejuar gjithashtu lëvizjen e sigurt të anijeve në Ngushticën e Hormuzit, tha një zyrtar amerikan për Radion Evropa e Lirë.

Ndërkohë, Axios, duke cituar gjithashtu një zyrtar amerikan, raportoi se bisedimet do të zhvillohen në Katar. “Bisedimet teknike do të vazhdojnë për të gjitha fushat e memorandumit të mirëkuptimit. Të dyja palët do të tërhiqen për momentin dhe anijet do të mund të lëvizin lirshëm nëpër ngushticë”, tha zyrtari vonë në mbremjen e 28 qershorit.

Axios raportoi se të dyja palët planifikojnë të takohen më 30 qershor në kryeqytetin e Katarit, Doha. “Vendosëm të ndalim të gjitha aktivitetet kinetike”, u citua të ketë thënë zyrtari amerikan, duke përdorur termin që zakonisht i referohet sulmeve ushtarake.

Edhe agjencia gjermane e lajmeve DPA, duke cituar një zyrtar të lartë të administratës amerikane, raportoi se Uashingtoni pret që bisedimet të vazhdojnë në ditët në vijim. Vendndodhja e takimit nuk u bë e ditur.



“Asgjë nuk është anuluar”, citohet te ketë thënë zyrtari.

Megjithatë, zëvendësministri i Jashtëm i Iranit, Kazem Gharibabadi, tha më 29 qershor se grupi teknik punues nuk planifikohet që të takohet gjatë kësaj jave, raportoi agjencia iraniane e lajmeve, Tasnim. “Megjithëse konsultimet me Katarin, përfshirë ato lidhur me vazhdimin e zbatimit të zotimeve të palës tjetër, po vazhdojnë si zakonisht, lajmet e publikuara nga disa media se në Doha po zhvillohen bisedime teknike nga grupet punuese nuk mund të konfirmohen”, u tha gazetarëve Gharibabadi.

Ai shtoi se rundi i parë i

bisedimeve teknike do të mbahet në kuadër të grupeve të caktuara të punës sapo të krijohen kushtet dhe pasi të arrihet marrëveshje për datën dhe vendin e zhvillimit të tyre, duke theksuar se konsultimet për këtë çështje po vazhdojnë përmes shteteve ndërmjetëse. Këto deklarata vijnë pasi Irani, duke përmendur sulmet amerikane ndaj vendit dhe ato që i cilësoi si shkelje të memorandumit të mirëkuptimit të arritur së voni, refuzoi të takohet me negociatorët amerikanë sipas planit më 28 qershor. “Për shembull, një nga arsyet është të verifikojmë nëse kemi qasje në fondet e

zhbllokuara. Nëse nuk kemi qasje, atëherë ky kusht nuk është përmbushur”, tha Mehdi Fazaeli nga zyra e udhëheqësit suprem të Iranit. Detaje të tjera nuk ishin menjëherë të disponueshme. Seanca e ardhshme, më 30 qershor, ishte planifikuar fillimisht të mbahej në Zvicër për të diskutuar programin bërthamor të Iranit. Megjithatë, Axios raportoi se përshkallëzimi i fundit i sulmeve nga të dyja palët bëri që bisedimet të zhvendoseshin në Katar, dhe tani ato do të përqendrohen mbi Ngushticën e Hormuzit. Irani, i cili pretendon sovranitet mbi këtë rrugë ujore strategjike,

ka qëlluar ndaj anijeve tregtare në ngushticë, duke bërë që forcat amerikane të godasin radarë bregdetarë dhe objekte ushtarake iraniane në përpjekje për të mbrojtur lundrimin.

Gjatë rundeve të mëparshme të negociatave, Uashingtoni dhe Teherani ranë dakord të krijojnë një linjë komunikimi ndërmjet ushtrisë amerikane dhe Gardës Revolucionare Islamike të Iranit (IRGC) për të koordinuar trafikun e anijeve dhe çështje të tjera. Megjithatë, sipas Axios, kjo linjë nuk ishte ende funksionale. Më 24 qershor, Sekretari amerikan i Shtetit, Marco Rubio, kishte deklaruar se bisedime të mëtejshme në nivel teknik mund të zhvilloheshin më 29 ose 30 qershor, dhe se ato me gjasë do të mbaheshin në Zvicër. Presidenti amerikan, Donald Trump, dhe homologu i tij iranian, Masud Pezeshkian, në fillim të qershorit nënshkruan një memorandum të përkohshëm mirëkuptimi me 14 pika, i cili u jep palëve 60 ditë kohë për të negociuar një marrëveshje përfundimtare që synon t'i japë fund luftës që filloi më 28 shkurt.

Katari, së bashku me Pakistanin, ka shërbyer si ndërmjetës mes Uashingtonit dhe Teheranit në rundin aktual të negociatave.

RCC: EVROPA NUK MUND T'I LEJOJË VETES ÇËSHTJE TË PAPËRFUNDUARA NË GJASHTË VENDET E BALLKANIT PERËNDIMOR

DUBROVNIK, 29 QERSHOR - Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal (RCC), Amer Kapetanović, mori pjesë në Forumin e 19-të të Dubrovnikut, ku foli në panelin "Bashkimi Evropian dhe Ballkani Perëndimor: Zgjidhja e çështjeve të papërfunduara së bashku".

I mbajtur nën temën kryesore "Epoka e multipolaritetit: Shumë drejtime, një e ardhme", Forumi i sivjetshëm mbledhi udhëheqës politikë, diplomatë, politikëbërës dhe ekspertë për të diskutuar ndryshimet në rendin global, sigurinë dhe pozicionin strategjik të Evropës, si dhe rëndësinë e bashkëpunimit në një mjedis ndërkombëtar gjithnjë e më të fragmentuar.

Paneli u përqendrua në urgjencën e ripërtëritjes strategjike të angazhimit të Bashkimit Evropian me gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor dhe në nevojën për të kaluar nga zotimet politike drejt zbatimit të besueshëm.

Pjesëmarrësit diskutuan se si të ruhet një proces zgjerimi i drejtë dhe i bazuar në merita, duke iu përgjigjur njëkohësisht presioneve në rritje gjeopolitike

dhe të sigurisë, progresit të pabarabartë në rajon dhe nevojës për një konsolidim më të shpejtë evropian. "Angazhimi i Bashkimit Evropian me gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor nuk është më vetëm çështje e politikës së zgjerimit; ai është një domosdoshmëri strategjike për Evropën në tërësi. Rajonit i nevojitet një rrugë e besueshme, e drejtë dhe e bazuar në merita drejt anëtarësimit, por besueshmëria duhet të shoqërohet me rezultate. Zotimet politike duhet të përkthehen në reforma, investime, bashkëpunim më të fuqishëm rajonal dhe përfitime konkrete për qytetarët. Në një botë më të fragmentuar dhe më të pasigurt, përfundimi i projektit evropian nënkupton integrimin e vendosur të gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor në familjen evropiane", tha Sekretari i Përgjithshëm i RCC-së, Amer Kapetanović.

Në panelin e moderuar nga Alexander Rhotert, ish-kolonel i Bundeswehr-it dhe ish-shef i kabinetit të Zyrës së Përfaqësuesit të Lartë, krahas Sekretarit të Përgjithshëm të



Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal (RCC), Amer Kapetanović, morën pjesë: Gordan Grlić Radman, Ministër i Punëve të Jashtme dhe Evropiane i Kroacisë; Ervin Ibrahimović, Zëvendëskryeministër dhe Ministër i Punëve të Jashtme i Malit të Zi; Ferit Hoxha, Ministër për Evropën dhe Punët e Jashtme i Shqipërisë; Elmedin Konaković,

Ministër i Punëve të Jashtme i Bosnjë e Hercegovinës; Željana Zovko, anëtare e Parlamentit Evropian; dhe Ulrike Hartmann, e Dërguar e Posaçme për Evropën Juglindore dhe Zgjerimin e Bashkimit Evropian në Ministrinë për Çështje Evropiane dhe Ndërkombëtare të Austrisë.

Në margjinat e Forumit të

Dubrovnikut, Kapetanović zhvilloi gjithashtu një takim të shkurtër dypalësh me Ministrin e Punëve të Jashtme dhe Evropiane të Sllovenisë, Tone Kajzer. Takimi ofroi mundësi për shkëmbim mendimesh mbi bashkëpunimin rajonal dhe perspektivën evropiane të gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor.

PESË ANKESA NË PZAP NDAJ REZULTATEVE ZGJEDHORE, KQZ-ja PRET VENDIMET PARA CERTIFIKIMIT

Prishtinë, 29 qershor - Pesë ankesa janë dorëzuar në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP) ndaj rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve të parakohshme për Kuvendin e Kosovës, duke shtyrë për momentin procesin e certifikimit të rezultateve.

Sipas të dhënave të publikuara në faqen zyrtare të PZAP-it, ankesa janë paraqitur nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK), Lista Serbe (Srpska Lista) dhe Nova Demokratska Stranka (NDS). Dy ankesa janë dorëzuar nga PDK, dy nga NDS dhe një nga Lista Serbe.



Lidhur me këtë, zëdhënësi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Valmir Elezi,

ka deklaruar se KQZ-ja nuk komenton çështjet që ndodhen në procedurë ankimore.

"Komisioni Qendror i Zgjedhjeve nuk komenton çështjet që janë në proces ankimor. Si në çdo rast, KQZ do t'i përgjigjet, brenda afatit, kërkesës së PZAP-it, institucionit kompetent për shqyrtimin e ankesave në procesin zgjedhor, duke sqaruar të gjitha çështjet e nevojshme", ka thënë Elezi.

Ai shtoi se certifikimi i rezultateve do të bëhet vetëm pasi të përfundojnë të gjitha procedurat ligjore. "Pasi ndaj rezultateve përfundimtare të shpallura nga KQZ janë parashtruar disa ankesa, KQZ do të presë vendimmarrjen e PZAP-it dhe të

Gjykatës Supreme, të zbatojë vendimet e tyre nëse përmbajnë obligime për KQZ dhe pastaj do të mund të procedojë me certifikimin e rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve të parakohshme për Kuvendin e Kosovës", ka deklaruar Elezi.

Ankesat e paraqitura kanë të bëjnë kryesisht me pretendime për parregullsi me votat dhe mungesë të votave.

Pas vendimmarrjes së PZAP-it, palët do të kenë të drejtë anekese edhe në Gjykatën Supreme, përpara se KQZ të mund të certifikojë rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve.

Serwer: Formimi i institucioneve në Kosovë kërkon kompromise

PRISHTINË, 29 QERSHOR - Profesi amerikan Daniel Serwer ka folur për situatën politike në Kosovë dhe bllokadën institucionale, duke thënë se për krijimin e institucioneve të reja do të jenë të nevojshme kompromiset mes partive politike.

Në një intervistë për "Ekonomia Online", Serwer ka thënë se Kosova ka kaluar një vit jo të mirë politikisht, duke iu referuar moszgjedhjes së presidentit dhe vështirësive në formimin e

institucioneve. "Është e vështirë të përcillet një imazh i stabilitetit të institucioneve dhe i qëndrueshmërisë së tyre kur nuk arrini të formoni një qeveri, kur nuk mund të zgjidhni presidentin", ka thënë Serwer.

Ai ka shprehur bindjen se kësaj here institucionet do të formohen, por ka theksuar se partitë do të duhet të bashkëpunojnë më shumë. "Kompromiset do të jenë të nevojshme. Njerëzit do të duhet të qeverisin së bashku, ndoshta

pak më shumë se në të kaluarën, por kjo është e realizueshme dhe shpresoj që të bëhet", ka deklaruar ai.

Serwer ka theksuar gjithashtu se, pavarësisht qeverive të ndryshme që ka pasur Kosova ndër vite, marrëdhënia me Shtetet e Bashkuara të Amerikës mbetet e pandryshuar. "Siç thashë, Kosova ka pasur qeveri të ndryshme gjatë viteve, por në thelb miqësia ndaj Shteteve të Bashkuara nuk ka ndryshuar", ka thënë Serwer.





PROCESI NDAJ KATËR ISH-KRERËVE TË UÇK-së PO I AFROHET FUNDIT

Pas më shumë se tre vjetësh gjykim, procesi ndaj katër ish-krerëve të UÇK-së po i afrohet fundit. Sipas njohësve të drejtësisë ndërkombëtare dhe Ballkanit, aktgjykimi nuk do të jetë vetëm një përgjigje për përgjegjësinë penale të të akuzuarve. Ai mund të ndikojë edhe në mënyrën se si do të lexohet lufta e Kosovës dhe trashëgimia e saj në vitet që vijnë

PRISHTINË, 29 QERSHOR - Për vite me radhë, lufta e Kosovës është rrëfyer përmes historisë, politikës dhe kujtesës kolektive. Së shpejti, asaj do t'i shtohet edhe një kapitull gjyqësor. Dhomat e Specializuara në Hagë - të njohura si Gjykata Speciale - pritet të shpallin aktgjykimin për katër ish-udhëheqësit e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës: Hashim Thaçin, Kadri Veselin, Jakup Krasniqin dhe Rexhep Selimin. Ata akuzohen për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit, që pretendohet se janë kryer gjatë dhe menjëherë pas luftës në Kosovë. Fillimisht, Trupi Gjyqësor kishte afat deri më 19 maj për të shpallur vendimin. Por, duke u thirrur në kompleksitetin e rastit, ai vendosi ta shtyjë këtë afat deri më 20 korrik 2026. Kjo datë, po ashtu, mund të mos jetë përfundimtare. Në një përgjigje për Radion Evropa e Lirë, Dhomat e

Specializuara thanë se mund të ketë ende ndryshime në afatet e parashikuara. "Gjyqtarët mund të vendosin për një shtyrje tjetër, nëse ajo konsiderohet absolutisht e nevojshme. Sapo paneli të caktojë një datë për shpalljen e vendimit, ne do ta bëjmë të ditur", thuhet në përgjigje. Thaçi dhe të bashkëpunuesit e tij - të gjithë figura të larta të UÇK-së gjatë luftës së viteve 1998 dhe 1999 - ndodhen në paraburgim në Hagë që nga nëntori i vitit 2020, kur u bë publike aktakuza kundër tyre. Në atë dosje, ata përshkruhen si pjesë e një "ndërmarrjeje të përbashkët kriminale", që synonte marrjen dhe ushtrimin e kontrollit përmes frikësimit, keqtrajtimit dhe largimit të kundërshtarëve. Sipas aktakuzës, viktimat e tyre përfshinin serbë, romë dhe shqiptarë që nuk mbështesnin UÇK-në. Së paku 102 persona dyshohet se u vranë, ndërsa më

shumë se 20 mbeten të zhdukur. Prokuroria pretendon gjithashtu se të akuzuarit, për shkak të pozitave të tyre drejtuese, mbajnë përgjegjësi edhe për krimet e kryera nga vartësit e tyre. Sot, mbi tre vjet pas nisjes së gjyqimit, trupi gjyqësor ka dëgjuar dhjetëra dëshmitarë dhe ka shqyrtuar qindra prova të paraqitura nga prokuroria dhe mbrojtja. Në përfundim të procesit, prokuroria kërkoi dënim me nga 45 vjet burg për secilin prej katër të akuzuarve. "Zyra e Prokurorit të Specializuar ka kërkuar vendim dënimi për të dhjetë pikat e aktakuzës dhe vendosjen e një vendimi të vetëm prej 45 vjetësh, bazuar në kontributet individuale në krime...", tha prokurorja e specializuar, Kimberly West, më 9 shkurt 2026. Të katërtit i kanë mohuar akuzat. Thaçi, i cili gjatë viteve ka mbajtur postet e kryeministrit dhe presidentit të Kosovës, i ka cilësuar ato si "krejtësisht të pavërteta, absurde dhe thellësisht fyese". "Është e vërtetë e dhimbshme që kjo prokurori përpigjet t'i hedhë poshtë dëshmitë e zyrtarëve të lartë të NATO-s, Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Britanisë së Madhe dhe OKB-së në këtë gjykatë - të atyre dhe njerëzve të tyre që ishin tërë kohën bashkë me ne në terren", ka thënë Thaçi duke iu drejtuar gjykatës më 18 shkurt 2026. Në mbështetje të mbrojtjes kanë

dëshmuar disa prej figurave më të njohura të diplomacisë dhe sigurisë perëndimore të kohës së luftës, përfshirë ish-zëdhënësin e Departamentit amerikan të Shtetit, James Rubin, dhe ish-komandantin e NATO-s për Evropën, Wesley Clark. Ata kanë deklaruar se UÇK-ja nuk funksiononte si një strukturë e centralizuar dhe se të akuzuarit kishin më pak ndikim dhe kontroll sesa pretendohet në aktakuzë. Ky është një qëndrim që ndan edhe një pjesë e konsiderueshme e qytetarëve të Kosovës, të cilët vazhdojnë t'i shohin Thaçin dhe bashkëluftëtarët e tij si figura të luftës çlirimtare. Në disa raste, ata kanë protestuar kundër gjyqit, duke e konsideruar atë të padrejtë dhe të njëanshëm. Për një pjesë të tyre, përfshirë edhe përfaqësues politikë, përqendrimi i Gjykatës vetëm te krimet e pretenduara të pjesëtarëve të UÇK-së krijon perceptimin e barazimit të luftës së Kosovës me krimet e kryera nga Serbia, e cila ishte shteti agresor gjatë luftës së viteve 1998-1999.

Sytë tani janë te gjyqtarët - cili do të jetë verdikti?

Përgjigja nuk është e njëjtë as mes juristëve dhe studiuesve që e kanë ndjekur nga afër procesin. Disa presin aktgjykim lirues, të

tjerë shmangin çdo parashikim, ndërsa ka edhe nga ata që shohin disa skenarë të mundshëm. Për avokatin e licencuar në Dhomat e Specializuara, Artan Qerkini, Prokuroria nuk ka arritur të provojë dy shtyllat kryesore mbi të cilat mbështetet aktakuza: ekzistencën e një ndërmarrjeje të përbashkët kriminale dhe përgjegjësinë komanduese të të akuzuarve. Për këtë arsye, ai pret që të katërtit të shpallen të pafajshëm. "Ushtria Çlirimtare e Kosovës ka qenë një ushtri vullnetare dhe nuk ka pasur hierarki strikte. Pjesëtarët e saj i janë bashkuar me vullnetin e tyre, nuk kanë qenë ushtarë profesionistë dhe nuk kanë pasur detyrime që t'i qëndronin luftës deri në fund. Në rrethana të tilla, nuk mund të thuhet se ka ekzistuar kontroll efektiv në terren, që është një nga bazat për përcaktimin e ndërmarrjes së përbashkët kriminale", thotë Qerkini për programin Expose të Radios Evropa e Lirë. Megjithatë, jo të gjithë janë të gatshëm të nxjerrin përfundime për rezultatin. Profesori i së Drejtës Ndërkombëtare në Universitetin Middlesex të Londrës, William Schabas, thotë se procese të kësaj natyre shpesh vendosen nga detaje të caktuara të provave, të cilat nuk janë gjithmonë të dukshme për publikun. "Gjyqtarët që po e shqyrtojnë këtë rast, nuk janë nga Kosova. Ata nuk

PROTESTOHET EDHE NË KROACI PËR ISH-KRERËT E UÇK-së: 'LIRI PËR ÇLIRIMTARËT'

PRISHTINË, 29 QERSHOR - Më 5 korrik nga ora 18:00 do të mbahet protestë në Kroaci, për të kërkuar lirimin e ish-krerëve të UÇK-së në Hagë. Kjo u bë me dije nga kryetari i OVL-UÇK-së, Hysni Gucati në një konferencë për media. "Konferenca ka të bëjë me protestën e radhës e cila

do të mbahet në Zarë të Kroacisë: 'Liri për çlirimtarët'. Ne e dimë që jemi në fund të procesit në Hagë dhe shpresojmë që më 20 korrik do të jetë në favorin tonë gjithë ajo punë që është bërë nga mbrojtja dhe nga ne. Ne do ta mbajmë një protestë ditën e diel, më 5 korrik,

në orën 18:00 të organizuar nga shqiptarët në Kroaci dhe nga kroatët", ka thënë ai. Gucati i ka bërë thirrje mërgatës që t'i bashkohen kësaj proteste. "Ju bëjmë thirrje gjithë qytetarëve që jetojnë, punojnë e veprojnë në shtetin kroat, pra edhe mërgatës të cilët janë edhe

në pushime në Kroaci apo kudo që janë, që me datën 5 korrik, ditë e diel, në orën 18:00, në Zarë të Kroacisë t'i bashkëngjiten protestës " 'Liri për çlirimtarët'. Protesta do të mbahet në Park në Zarë. Shpresoj se aty do të marrin pjesë edhe arbëreshët, sepse janë dy lagje arbëreshe me

vite e vite që jetojnë në Zarë ku është edhe kërkesë e tyre, pasi edhe ata kanë kërkuar ta mbajnë një protestë për çlirimtarët tonë", ka shtuar Gucati. Ai shpreson se kjo do të jetë protesta e fundit, me besimin se çlirimtarët do të kthehen në Kosovë.



janë të shkëputur nga realiteti politik i Kosovës, sepse ai është pjesë e çështjes që po gjykohet. Por, ata janë të pavarur dhe të paanshëm. Mendoj se shqetësimet apo ndjeshmëritë që mund të shkaktojë vendimi i tyre, nuk ndikojnë në punën e tyre - ata do të vendosin mbi bazën e fakteve dhe provave që kanë para vetes", thotë Schabas për Exposenë.

Si hulumtuese prej vitesh e Tribunalit të Hagës për ish-Jugosllavinë dhe vëzhguese e afërt e procesit ndaj Thaçit dhe të tjerëve, Nevenka Tromp nuk e përjashton asnjë mundësi.

Sipas saj, ekzistojnë tre skenarë: shpallja e pafajësisë për të katërtit, dënimi i të katërtve, ose një rezultat i përzier, ku disa mund të dënohen e disa të lirohen.

Pikërisht të tretin ajo e sheh si më të mundshmin. "Kjo gjykatë do të duhet të ruajë një lloj ekuilibri mes pritjeve të palës serbe dhe asaj kosovare. Për këtë arsye, ka gjasa që disa të akuzuar të shpallen të pafajshëm dhe disa të dënohen. Mbetet të shihet nëse do të lirohet një apo do të dënohet një... apo ndonjë kombinim tjetër. Por, do të ketë kompromis", thotë Tromp për Exposenë.

Vëmendja e Trompit nuk ndalet vetëm te rezultati. Ajo

argumenton se gjatë zhvillimit të procesit, ka pasur shqetësimet serioze lidhur me standardet procedurale, përfshirë kohëzgjatjen e paraburgimit dhe mënyrën e zbatimit të prezumimit të pafajësisë. Ajo vëren se kritika të ngjashme janë ngritur edhe nga Këshilli i Avokatëve të Anglisë dhe Uellsit.

Raporti paraprak i këtij mekanizmi, i publikuar më 11 maj, ngriti shqetësimet për kohëzgjatjen e paraburgimit, kufizimet në lirimin e përkohshëm, pranimin e provave dhe barazinë mes prokurorisë dhe mbrojtjes gjatë procesit gjyqësor. Se si do të ndikojnë këto kritika në perceptimin e aktgjykimit mbetet për t'u parë. Sepse, për një pjesë të ekspertëve, verdikti është vetëm një pjesë e historisë. Pjesa tjetër fillon pasi ai të shpallet, në mënyrën se si do të lexohet dhe interpretohet në Kosovë dhe më gjerë.

Këtu e vendos fokusin edhe sociologu dhe profesori në Universitetin e Londrës, Eric Gordy.

Sipas tij, një nga dobësitë më të mëdha të Dhomave të Specializuara ka qenë komunikimi me publikun. Në vend që qytetarëve t'u shpjegohej më shumë se procesi kishte të bënte me përgjegjësinë individuale, hapësira publike u

mbush me interpretime politike, ku gjykimi u paraqit si një përballje mes palëve ndërluftuese dhe jo si proces penal ndaj individëve. "Kush nuk do të donte të arrinte drejtësi historike? Por, unë do të doja që gjyqtarët të përqendroheshin më shumë te drejtësia juridike, ndërsa historianët dhe filozofët të merreshin me drejtësinë historike", thotë Gordy për Exposenë.

Gordy nuk pret që aktgjykimi të sjellë një narrativ të përbashkët për luftën në Kosovë. Përkundrazi - interpretimet, sipas tij, do të vazhdojnë të ndryshojnë, sepse ato ndërtohen mbi përvoja, kujtesë kolektive dhe këndvështrime të ndryshme politike e shoqërore.

Për këtë arsye, ai e sheh dialogun mes vetë shoqërive si rrugën më të kaluarën. "Duhet ta ndajmë historinë nga politika dhe të nxisim një dialog, ku njerëzit në secilin shtet flasin edhe për përgjegjësitë e atyre që i kanë përfaqësuar. Ndarja e njerëzve në heronj dhe armiq nuk i shërben askujt", sipas Gordyt. Profesori Schabas është gjithashtu skeptik se një vendim gjyqësor mund të prodhojë pajtim.

Duke iu referuar përvojës së Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë, ai thotë se

edhe pas dhjetëra aktgjykimeve dhe më shumë se dy dekadash punë, ndikimi i tij në afërmin e shoqërive të rajonit mbetet i kufizuar.

Sipas Schabasit, një skenar i ngjashëm mund të përsëritet edhe pas vendimit të Dhomave të Specializuara. "Nëse aktgjykimi është kundër tyre, do të ketë njerëz që nuk do ta pranojnë lehtë. Thjesht, për shkak të besnikërisë dhe bindjeve të tyre, jo për shkak të një vlerësimi të ftohtë e të paanshëm të ligjit", thotë ai.

Për Qerkinin, një aktgjykim dënues do të kishte peshë përtej përgjegjësisë individuale. Ai thotë se fakti që Gjykata ka trajtuar vetëm krimet e pretenduara të UÇK-së, ka ushqyer perceptimin e një drejtësie selektive, me pasoja të mundshme edhe për mënyrën se si do të perceptohet lufta e Kosovës. "Mund të ndikojë negativisht në perceptimin për UÇK-në, ngase të akuzuar janë krerët e UÇK-së. Pra, UÇK-ja nuk është përbërë nga armatimi dhe logjistika, por nga njerëzit. Dhe, këta njerëz të akuzuar kanë qenë krerët e UÇK-së dhe, domosdo, mund të kriminalizohet e gjithë UÇK-ja", thotë Qerkini.

Tromp shkon edhe më larg - perceptimi për UÇK-në nuk është i vetmi në lojë.

Ajo argumenton se një aktgjykim dënues mund të

ndikojë edhe në mënyrën se si do të rrefehet shtetësia e Kosovës në arenën ndërkombëtare, duke i dhënë Serbisë dhe vendeve skeptike më shumë hapësirë për të sfiduar legjitimitetin moral të luftës së saj çlirimtare.

Kjo, sipas saj, mund ta vendosë Kosovën në një pozitë më të vështirë në betejat diplomatike për njohje, si dhe në raportet me partnerët ndërkombëtarë. "Shoqëria e Kosovës dëshiron të pranohet në kontekstin politik evropian. Ajo dëshiron të ecë përpara dhe të ndërtojë të ardhmen e saj. Por, ky proces rrezikon ta mbajë të lidhur me të kaluarën dhe të vërë në dyshim qëllimet e mira dhe rezultatit që synon të arrijë kjo gjykatë", thotë Tromp.

E themeluar nga Kuvendi i Kosovës, Gjykata Speciale është pjesë e sistemit gjyqësor të vendit, por vepron në Hagë me gjyqtarë ndërkombëtarë.

Ajo pasoi raportin e ish-senatorit zviceran, Dick Marty, të vitit 2010, i cili ngriti pretendime për krime të rënda të ish-pjesëtarëve të UÇK-së, përfshirë trafikimin e organeve. Meqë këto të fundit nuk u vërtetuan dhe nuk janë pjesë e aktakuzës aktuale kundër Thaçit dhe të tjerëve, Qerkini thotë se Kosova është "mashtuar".

SERBIA MUND TË MOS E NJOHË KOSOVËN, POR BE-ja I PRET KOSOVËN DHE SERBINË SI DY SHTETE SOVRANE DHE TË PAVARURA



Nga: Prof. Dr. Fejzulla
BERISHA

Realiteti politik dhe realiteti juridik në Ballkanin Perëndimor

Që nga shpallja e pavarësisë së Republikës së Kosovës më 17 shkurt 2008, marrëdhëniet Kosovë - Serbi janë karakterizuar nga një dualizëm i vazhdueshëm midis realitetit politik të mosnjohjes dhe realitetit faktik të shtetësisë funksionale të Kosovës. Serbia vazhdon të mbajë qëndrim të mosnjohjes, ndërsa Kosova ka konsoliduar institucione shtetërore, marrëdhënie ndërkombëtare dhe pjesëmarrje në proceset rajonale dhe evropiane. Në këtë kontekst, Bashkimi Evropian paraqitet si korniza kryesore transformuese e këtij konflikti të pazgjidhur, duke e zhvendosur fokusin nga statusi përfundimtar në normalizimin e marrëdhënieve dhe integrimin gradual evropian.

Dallimi themelor: njohja bilaterale dhe integrimi multilateral evropian

Në të drejtën ndërkombëtare dhe në praktikën e marrëdhënieve ndërkombëtare, duhet bërë një dallim thelbësor: Njohja bilaterale është akt sovran i një

shteti ndaj një tjetri; Integrimi evropian është proces multilateral, i bazuar në kriteret politike, ekonomike dhe juridike (Kriteret e Kopenhagës). Ky dallim është thelbësor për të kuptuar se Bashkimi Evropian nuk funksionon si mekanizëm i detyrimit formal të njohjes së ndërsjellë, por si sistem i ndërtimit të stabilitetit përmes bashkëpunimit funksional. Megjithatë, në praktikë, BE-ja ka vendosur një standard politik: pa normalizim të marrëdhënieve, nuk ka progres të qëndrueshëm drejt anëtarësimit.

Krahasim juridik dhe politik: modele evropiane të konfliktit dhe integritit

1. Rasti Francë - Gjermani (modeli klasik i pajtimit evropian)

Pas dy luftërave botërore, Franca dhe Gjermania ishin në një raport armiqësor historik. Megjithatë: Nuk u kërkua "zgjidhje përfundimtare juridike" menjëherë; U vendos bashkëpunimi ekonomik si bazë e paqes (Komuniteti i Qymyrit dhe Çelikut); Integrimi evropian u bë instrument i tejkallimit të konfliktit. Mësimi: Evropa nuk kërkon perfeksion juridik të menjëhershëm, por stabilitet funksional.

2. Rasti Qipro - Turqi (ndarje e pazgjidhur brenda BE-së)

Qipro është anëtare e BE-së, ndërsa pjesa veriore mbetet e ndarë dhe e njohur vetëm nga Turqia. BE nuk e ka kushtëzuar funksionimin e saj të brendshëm me zgjidhjen e konfliktit; Por ka ngrirë progresin e Turqisë në BE

në disa fusha për shkak të moszgjidhjes së çështjes së Qipros. Mësimi: moszgjidhja e konflikteve territoriale ndikon drejtpërdrejt në integrim.

3. Rasti Kosovë - Serbi (modeli i "normalizimit pa njohje formale")

Ky është një model sui generis: BE ka ndërmjetësuar dialogun që nga viti 2011; Marrëveshjet e Brukselit dhe Ohrit synojnë normalizim funksional, jo domosdoshmërisht njohje të menjëhershme; Të dy palët trajtohen si aktorë të barabartë në dialog, por me status të ndryshëm diplomatik. Mësimi: BE operon me pragmatizëm politik më shumë sesa me formalizëm juridik klasik.

Dimensioni juridik: shtetësia dhe mosnjohja selektive

Në të drejtën ndërkombëtare, teoria klasike e Montevideos (1933) përcakton katër elemente të shtetit:

1. Popullsi e përhershme
2. Territor i përcaktuar
3. Qeveri efektive
4. Aftësi për marrëdhënie



ndërkombëtare Kosova i plotëson këto elemente në mënyrë funksionale. Nga ana tjetër, mosnjohja nga Serbia dhe disa shtete të tjera nuk e anulon faktin e shtetësisë funksionale, por krijon një situatë të "kontestuar ndërkombëtarisht". Krahasimisht: Tajvani, Palestina dhe Kosova përfaqësojnë modele të ndryshme të shtetësisë së kontestuar; Por secili ka nivel të ndryshëm integrimi ndërkombëtar dhe funksionaliteti institucional.

Dimensioni i Bashkimit Evropian: realpolitik dhe normativitet

Bashkimi Evropian nuk është vetëm organizatë juridike; ai është edhe projekt politik. Në raport me Kosovën dhe Serbinë, BE aplikon: Realpolitik: stabiliteti rajonal është prioritet; Normativitet: sundimi i ligjit dhe vlerat demokratike janë kushte bazë.

Ky dualitet krijon një qasje hibride: Nuk kërkohet domosdoshmërisht njohje e menjëhershme; Por kërkohet mosbllokim i funksionimit të shtetit tjetër dhe normalizim i marrëdhënieve.

Perspektiva strategjike: dy shtete në një familje evropiane

Në perspektivën afatgjatë të BE-së, Ballkani Perëndimor nuk mund të mbetet zonë konflikti të ngrirë.

Modeli i synuar është: dy shtete sovraane dhe të pavarura (Kosova dhe Serbia), të integruara në BE, me kufij politikë por pa kufij konfliktualë, me bashkëpunim institucional të detyrueshëm. Ky vizion është i ngjashëm me transformimin historik të Evropës Perëndimore pas vitit 1945.

Realiteti evropian si tejkallim i mohimit politik

Serbia mund të vazhdojë të mos e njohë Kosovën në nivel deklarativ politik, por procesi i integritit evropian nuk është i ndërtuar mbi qëndrime statike, por mbi transformimin gradual të marrëdhënieve ndërmjet shteteve.

Bashkimi Evropian, në esencë, nuk e ndërton të ardhmen mbi mohimin e realiteteve, por mbi menaxhimin e tyre përmes dialogut, integritit dhe standardizimit institucional. Prandaj, perspektiva më e qëndrueshme për rajonin mbetet e qartë:

Kosova dhe Serbia, pavarësisht qëndrimeve të ndryshme për statusin, janë të destinuar të funksionojnë si dy shtete sovraane dhe të pavarura në kuadër të së njëjtës familje evropiane.

Ky nuk është vetëm një projekt politik; është një domosdoshmëri historike dhe një kusht për paqen e qëndrueshme në Ballkanin Perëndimor.

QENDRA HISTORIKE E PRIZRENIT KËRKON MBIKËQYRJE MË TË FUQISHME INSTITUCIONALE

PRIZREN, 29 QERSHOR - EC Ma Ndryshe, në kuadër të monitorimit të çështjeve që lidhen me planifikimin urban, mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe interesin publik, ka pranuar shqetësime nga komuniteti lidhur me punimet për ndërtimin e një objekti në rrugën "Shën Albani". Pas qasjes në dokumentacionin zyrtar të institucioneve kompetente, organizata vëren se si Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturorë (QRTK) në Prizren, ashtu edhe Drejtoria e Inspektoratit e Komunës së Prizrenit, kanë konstatuar mospërputhje ndërmjet punimeve të realizuara në terren dhe projektit të aprovuar. Sipas njoftimit të QRTK-së, gjatë monitorimit të punimeve janë



evidentuar ndërhyrje që nuk janë në përputhje me pëlqimin e lëshuar nga institucionet përgjegjëse për trashëgiminë kulturore dhe, për pasojë, është kërkuar reagim nga Drejtoria e

Inspektoratit. Ndërkaq, Drejtoria e Inspektoratit ka konstatuar se punimet nuk janë duke u zhvilluar sipas projektit të aprovuar dhe në përputhje me pëlqimet përkatëse, duke

evidentuar tejkallime që nuk figurojnë në projektin e miratuar. Për këtë arsye, Inspektorati ka theksuar se ka ndërmarrë veprime administrative dhe ka vendosur masa ndaluese në objekt. Njëherësh, ka bërë të ditur se do të vazhdojë me ndërmarrjen e veprimeve të tjera ligjore. Sipas të dhënave të QRTK-së, parcela ku po realizohet ndërtimi gjendet brenda kufijve të Qendrës Historike të Prizrenit.

EC Ma Ndryshe konsideron se respektimi i kushteve të lejeve ndërtimore dhe i pëlqimeve të institucioneve përgjegjëse për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore është detyrim ligjor dhe parakusht për zhvillim të qëndrueshëm urban, veçanërisht në zona që

ndodhen brenda ose pranë hapësirave me vlera të trashëgimisë kulturore.

Duke marrë për bazë edhe shqetësimet e komunitetit, EC Ma Ndryshe kërkon nga institucionet përgjegjëse që të sigurojnë zbatimin e plotë të dispozitave ligjore dhe kushteve të përcaktuara në lejet e lëshuara, të informojnë publikun për hapat e ndërmarrë lidhur me këtë rast dhe të forcojnë mbikëqyrjen institucionale në zonat me ndjeshmëri të lartë urbanistike dhe trashëgimore.

EC Ma Ndryshe përkujton se ruajtja e autenticitetit dhe integritetit të Qendrës Historike të Prizrenit është detyrim ligjor dhe përgjegjësi e qytetare për bashkëpunimin institucional dhe qytetare.

Universiteti i Prishtinës hap konkursin për pranimin e studentëve për vitin akademik 2026/2027

PRISHTINË, 29 QERSHOR - Universiteti i Prishtinës (UP) ka shpallur konkursin për pranimin e studentëve të rinj në vitin e parë të studimeve në nivelin baçelor dhe master për vitin akademik 2026/2027. Sipas njoftimit zyrtar, në afatin e parë planifikohet të

regjistrohen 5 663 studentë të rregullt në nivelin baçelor, ndërsa në nivelin master janë paraparë 2 423 vende, përfshirë edhe 9 studentë ndërkombëtarë. Programet e studimit të ofruara nga UP mbulojnë fusha të ndryshme akademike

dhe janë përshtatur me kërkesat e tregut të punës, me qëllim që studentëve t'u ofrohen njohuri dhe aftësi për zhvillim profesional. Universiteti i Prishtinës ka bërë me dije se mbetet i përkushtuar në krijimin e një mjedisi cilësor akademik dhe

në mbështetjen e studentëve gjatë rrugëtimit të tyre arsimor e profesional. Të gjithë të interesuarit janë ftuar të aplikojnë dhe të bëhen pjesë e Universitetit të Prishtinës, një prej institucioneve kryesore të arsimit të lartë në vend.



DELEGACIONI I MINISTRISË SË MBROJTJES ZHVILLOI VIZITË ZYRTARE NË BERLIN NË KUADËR TË BASHKËPUNIMIT BILATERAL ME GJERMANINË

PRISHTINË, 29 QERSHOR - Në kuadër të bashkëpunimit dypalësh në mes të Ministrisë së Mbrojtjes së Kosovës dhe të Republikës Federale të Gjermanisë, nga data 23 deri më 25 qershor u realizuan vizita dhe takimet zyrtare në Ministrinë e Mbrojtjes Federale në Berlin.

Delegacioni i Ministrisë së Mbrojtjes u përfaqësua nga drejtori i Departamentit për Politika dhe Strategji, Azem Smajli, i shoqëruar nga shefi i Sektorit për Bashkëpunim Bilateral dhe Multilateral, nënkolonel Gëzim Sada dhe atasheu i mbrojtjes së Republikës së Kosovës në Gjermani, kolonel Bekim Zejnullahu.

Delegacioni i Ministrisë Federale të Mbrojtjes së Republikës

Federale të Gjermanisë, i përbërë nga zyrtarë të lartë, u kryesua nga udhëheqësi i Departamentit për Evropën Lindore, Azinë dhe Oqeaninë, kolonel Nils Heiko Hutter.

Takimet dhe diskutimet ndërmjet dy delegacioneve u zhvilluan në disa sesione, gjatë të cilave u trajtuan tema me rëndësi strategjike, përfshirë situatën e sigurisë në botë dhe në Evropë, luftën në Ukrainë, si dhe krizat në rajone të tjera. Me theks të veçantë u diskutua roli i të dy vendeve për të mbështetur Ukrainën, përmes angazhimit diplomatik, ushtarak dhe financiar.

Një pjesë e rëndësishme e diskutimeve iu kushtua zhvillimit të Forcës së Sigurisë së Kosovës



(FSK) dhe zhvillimeve në kuadër të NATO-s. Delegacioni gjerman u informua për progresin e arritur nga FSK-ja, duke u theksuar se ajo aktualisht ndodhet në fazën III të tranzicionit, me synimin për të arritur kapacitetet e plota operacionale deri në vitin 2029.

Gjatë takimeve u diskutua edhe për bashkëpunimin ndërkombëtar dhe kontributin në operacionet ndërkombëtare. Në këtë kuadër u diskutua për zhvillimet, të cilat do të rrisin kapacitetet dhe aftësitë ushtarake të FSK-së, si dhe do të

kontribuojnë për sigurinë dhe stabilitetin ndërkombëtar përmes mbështetjes së partnerëve duke marrë pjesë në misione dhe operacione ndërkombëtare.

Në sesionin kushtuar bashkëpunimit dypalësh dhe bashkëpunimit në fushën e armatimit dhe industrisë së mbrojtjes, delegacioni i Kosovës shprehu mirënjohjen për mbështetjen e vazhdueshme të Republikës Federale të Gjermanisë si dhe u ritheksua përkushtimi i Kosovës për forcimin e partneritetit strategjik me Gjermaninë, zhvillimin e sektorit të mbrojtjes sipas standardeve të NATO-s dhe kontributin e përbashkët për të ruajtur paqen dhe stabilitetin rajonal.

QKUK-ja REALIZON ME SUKSES SEANCËN E PARË TË IMUNOADSORBIMIT NË KOSOVË

PRISHTINË, 29 QERSHOR - Ekipi i mjekëve nefrolog në kuadër të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës (QKUK) ka realizuar me sukses seancën e parë të imunoadsorbimit (IA), duke shënuar një hap të rëndësishëm në përmirësimin e shërbimeve nefrologjike dhe të kujdesit intensiv në vend.

Kjo procedurë e avancuar dhe shumë specifike plotëson gamën e modaliteteve më bashkëkohore të hemodializës akute dhe trajtimeve ekstrakorporale që ofrohen në ShSKUK, në funksion të trajtimit të patologjive komplekse dhe kërcënuese për jetën.

Seanca e parë e imunoadsorbimit është aplikuar tek pacienti Xh. K. (1979), i diagnostikuar me vaskulit c-ANCA, një sëmundje e rëndë akute e enëve të gjakut me përfshirje të veshkave dhe



mushkërive.

Qëllimi i trajtimit ka qenë eliminimi sa më i shpejtë i

citokinave dhe antitropave inflamatorë nga qarkullimi i gjakut, me synim kontrollimin e

procesit inflamator dhe parandalimin e dëmtimeve të mëtejme të organeve vitale.

Procedura është realizuar nga ekipi profesionist i përbërë nga dr. Siada Selmani, dr. Vjollca Godanci Kelmendi, infermierja Njomza Maliqi-Qirezi, me mbështetjen e stafit të Mjekimit Intensiv Qendror (MIQ) dhe teknikëve të aparaturës përkatëse.

Seanca ka kaluar pa komplikime dhe është shoqëruar me rezultate inkurajuese klinike, me ulje të shpejtë dhe të konsiderueshme të markerëve inflamatorë, me reduktim deri në 75 %.

Imunoadsorbimi është përdorur si terapi plotësuese krahas plazmaferzës dhe trajtimeve të tjera imunosupresive, në përpjekje për të përsheptuar kontrollin e procesit inflamator dhe për të përmirësuar prognozën e pacientit.

Zhvillimi dhe aplikimi i terapi moderne të pastrimit ekstrakorporal të gjakut, përfshirë plazmaferzën, imunoadsorbimin dhe terapitë e vazhdueshme të zëvendësimit të funksionit renal (CRRT), kanë zgjeruar ndjeshëm mundësitë terapeutike për pacientët me sëmundje të rënda dhe gjendje kritike.

Implementimi i imunoadsorbimit në QKUK përfaqëson një arritje të rëndësishme institucionale dhe një dëshmi të përkushtimit për ngritjen e vazhdueshme të kapaciteteve profesionale dhe teknologjike në përputhje me standardet bashkëkohore mjekësore.

Kjo teknologji moderne pritet të kontribuojë në përmirësimin e mbijetesës së pacientëve, uljen e morbiditetit dhe ofrimin e trajtimeve të avancuara për rastet komplekse dhe kërcënuese për jetën.

FSK-ja investon në profesionalizimin dhe aftësimin e personelit ushtarak

PRISHTINË, 29 QERSHOR - Pjesëtarë të Forcës së Sigurisë së Kosovës kanë përfunduar me sukses trajnimin për snajper me qëllim të ngritjes së kapaciteteve luftarake dhe avancimit të aftësive profesionale të personelit

ushtarak. Trajnimi kishte për synim certifikimin e pjesëtarëve si snajperistë operativë, të aftë për të vepruar sipas standardeve moderne ushtarake dhe për të përdorur sisteme të ndryshme të armëve

në misione të ndryshme operative. Gjatë trajnimit, pjesëmarrësit zhvilluan aftësi në qitje precize, taktika fushore, kamuflim, vëzhgim, lëvizje taktike dhe zbatimin e procedurave operacionale në terren.

Forca e Sigurisë së Kosovës vazhdon të investojë në zhvillimin profesional dhe operacion të personelit të saj, duke ngritur gatishmërinë dhe kapacitetet e forcës në përputhje me standardet më të larta ushtarake



Gërxhaliu: Ballkani Perëndimor mbetet shumë prapa Sllovenisë dhe Austrisë në eksporte

PRISHTINË, 29 QERSHOR - Ekonomisti Safet Gërxhaliu ka publikuar një analizë krahasuese mbi trendet ekonomike në Ballkanin Perëndimor, duke i vënë në raport me Slloveninë dhe Austrinë.

Sipas tij, dallimet në fuqinë eksportuese janë të mëdha dhe pasqyrojnë nivelin e zhvillimit ekonomik të vendeve. Sipas të dhënave të



prezantuar, gjashtë shtetet e Ballkanit Perëndimor realizuan rreth 49.6 miliardë euro eksporte në vitin 2025, ndërsa

Sllovenia eksportoiti rreth 72 miliardë euro dhe Austria 197 miliardë euro.

Gërxhaliu thekson se eksporti mesatar për banor në Ballkanin Perëndimor është rreth 2.970 euro, krahasuar me 33.800 euro në Slloveni dhe 21.400 euro në Austri.

Sipas tij, kjo do të thotë se Sllovenia eksporton rreth 11 herë më shumë për banor sesa mesatarja e rajonit, ndërsa

Austria rreth shtatë herë më shumë.

Ai vlerëson se këto dallime lidhen me strukturën e ekonomive.

Sllovenia dhe Austria mbështeten në industri me vlerë të shtuar të lartë, si prodhimi i makinerive, industria automobilistike, farmaceutike, elektronika dhe teknologjia, ndërsa shumica e vendeve të Ballkanit Perëndimor vazhdojnë

të mbështeten në lëndë të para, gjysmëprodukte dhe industri me intensitet të lartë pune.

Në përfundim, Gërxhaliu thekson se zhvillimi ekonomik kërkon stabilitet politik, orientim drejt forcimit të ekonomisë dhe partneritet rajonal e evropian, duke shtuar se "nuk jetohet nga patriotizmi folklorik dhe mungesa e një vizioni multidimensional për të ardhmen".

AKB: KOSOVARËT SHPENZOJNË RRETH 195 MILIONË EURO PËR TURIZËM NË SHQIPËRI VETËM GJATË FUNDJAVAVE, NË SEZONIN MAJ - TETOR

PRISHTINË, 29 QERSHOR - Aleanca Kosovare e Bizneseve (AKB), bazuar në studimin e realizuar gjatë periudhës 28 maj - 28 qershor 2026, konstaton se qytetarët e Kosovës vazhdojnë të jenë investitorët dhe konsumatorët më të mëdhenj të turizmit në Shqipëri.

Studimi i AKB-së, i cili përfshin pesë fundjava radhazi, tregon se mesatarisht rreth 25 mijë qytetarë nga Kosova kalojnë fundjavën në Shqipëri.

Gjatë një qëndrimi prej 2 - 3 netësh, ata shpenzojnë mesatarisht të paktën 300 euro për person, duke përfshirë akomodimin, gastronominë, pijet, transportin, derivatet e naftës, taksën rrugore, argëtimin dhe blerjet.

Bazuar në këto të dhëna, rezultojnë

se çdo fundjavë qytetarët e Kosovës shpenzojnë rreth 7.5 milionë euro në ekonominë shqiptare. Duke marrë për bazë sezonin turistik 1 maj - 30 tetor 2026, i cili përfshin 26 fundjava, rezultojnë se shpenzimet totale arrijnë në rreth 195 milionë euro, vetëm nga vizitat e fundjavës, pa përfshirë pushimet disa ditore apo javore gjatë verës.

AKB-ja vlerëson se këto shifra dëshmojnë qartë se Kosova është partneri dhe tregu më i rëndësishëm për turizmin shqiptar, duke dhënë një kontribut të drejtpërdrejtë në zhvillimin e hotelierisë, gastronomisë, tregtisë, transportit dhe sektorëve të tjerë shërbyes.

Aleanca Kosovare e Bizneseve konsideron se është koha që ky



bashkëpunim ekonomik të thellohet përmes investimeve të përbashkëta në turizëm, përmirësimit të infrastrukturës, lehtësimit të lëvizjes së qytetarëve, krijimit të ofertave të përbashkëta turistike dhe politikave që nxisin investimet

ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë.

Turizmi nuk është vetëm një sektor ekonomik, por edhe një urë që forcon lidhjet kombëtare, zhvillimin ekonomik dhe mirëqenien e qytetarëve në të dyja shtetet.

Agim Shahini, kryetar i Aleancës Kosovare të Bizneseve (AKB), ka thënë se studimi i tyre dëshmon qartë se qytetarët e Kosovës janë mbështetësit më të mëdhenj të turizmit shqiptar. "Rreth 195 milionë euro që shpenzohen vetëm gjatë 26 fundjavave të sezonit maj - tetor përbëjnë një kontribut të jashtëzakonshëm për ekonominë e Shqipërisë. Ky është një partneritet ekonomik që duhet të vlerësohet, të mbështetet dhe të zhvillohet më tej përmes politikave të përbashkëta, investimeve strategjike dhe krijimit të kushteve edhe më të favorshme për lëvizjen e lirë të qytetarëve dhe bizneseve. Kur fiton turizmi shqiptar, fitojnë edhe bizneset dhe qytetarët në të dy anët e kufirit", ka thënë Shahini.

PËRFAQËSUESIT E ZKA-SË PREZANTUAN PËRVOJËN E KOSOVËS NË PUNËTORINË NDËRKOMBËTARE PËR MENAXHIMIN E CILËSISË NË AUDITIM

PRISHTINË, 29 QERSHOR - Më 23-25 qershor 2026, përfaqësues të Zyrës Kombëtare të Auditimit (ZKA) morën pjesë në punëtorinë ndërkombëtare për Menaxhimin e Cilësisë, e mbajtur në Stamboll. Punëtorija u organizua nga Zyra Kombëtare e Auditimit të Suedisë në kuadër të aktiviteteve të projekt grupit të EUROSAI-t për zhvillim. ZKA-ja në këtë punëtori u përfaqësua nga Fitim Haliti, drejtor për Menaxhimin e Cilësisë, Ylber Sadiku, Auditor, dhe Lindita Ajeti, Auditor.

Gjatë punëtorisë, përfaqësuesit e ZKA-së prezantuan përvojën institucionale në hartimin dhe



zbatimin e Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë në Auditim, duke paraqitur progresin

e arritur në zhvillimin e politikave dhe procedurave përkatëse, menaxhimin e rreziqeve të

cilësisë, monitorimin dhe korigjimin e sistemit, vlerësimin vjetor të tij, si dhe procesin e Rishikimit të Cilësisë së Angazhimit.

Në prezantim u theksuan gjithashtu rezultatet konkrete të arritura deri më tani, përfshirë miratimin e objektivave të cilësisë, identifikimin dhe vlerësimin e rreziqeve të cilësisë, si dhe përcaktimin e prioritetëve për menaxhimin dhe adresimin e tyre.

Diskutimet gjatë punëtorisë konfirmuan se Zyra Kombëtare e Auditimit është njëra ndër institucionet supreme të auditimit

që ka avancuar në hartimin e dokumentacionit të nevojshëm sipas kërkesave të ISSAI 140 dhe ka filluar zbatimin praktik të Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë. Ky progres dëshmon angazhimin e ZKA-së për forcimin e cilësisë së auditimit përmes një qasjeje të bazuar në rrezik dhe përmirësim të vazhdueshëm.

Në këtë aktivitet morën pjesë përfaqësues nga institucionet supreme të auditimit të Kosovës, Shqipërisë, Azerbajxhanit, Bosnjë dhe Hercegovinës, Gjeorgjisë, Maqedonisë së Veriut, Moldavisë, Malit të Zi, Serbisë, Suedisë, Turqisë dhe Ukrainës.

Bie numri i ndërmarrjeve të regjistruara në maj krahasuar me një vit më parë

PRISHTINË, 29 QERSHOR - Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka publikuar repertorin statistikor mbi ndërmarrjet ekonomike në Kosovë për muajin maj 2026.

Në maj 2026 krahasuar me muajin paraprak, kemi rënie për 1,4 % të ndërmarrjeve të regjistruara.

Ndërsa krahasuar me muajin e njëjtë të vitit paraprak, kemi

rënie për 16,9 % të ndërmarrjeve të regjistruara.

Aktivitetet ekonomike më të preferuara gjatë këtij muaji ishin: Tregti me shumicë dhe pakicë, riparim i mjeteve motorike, motoçikletave me 278 (25,1 %), Akomodim dhe aktivitete të shërbimeve me ushqim me 126 (11,4 %), Ndërtimtari me 119 (10,7 %),

Prodhim me 105 (9,5 %), etj.

Në kategorinë "Mikro Ndërmarrje" (0 deri në 9 të punësuar) janë gjithsej 1 101 ndërmarrje të regjistruara, në kategorinë "Ndërmarrje të Vogla" (10 deri 49 të punësuar) janë gjithsej 7 ndërmarrje të regjistruara, në kategorinë "Ndërmarrje të Mesme" (50 deri 249 të punësuar) dhe në

kategorinë "Ndërmarrje të Mëdha" (250+), nuk kemi ndërmarrje të regjistruara këtë muaj.

Shtirirja gjeografike e ndërmarrjeve të regjistruara në nivel rajoni është: Rajoni i Prishtinës prinë me 523 ndërmarrje të regjistruara (7,2 %), rajoni i Prizrenit me 130 (11,7 %), rajoni i Ferizajt me 110 (9,9



%), rajoni i Mitrovicës me 100 (9,0 %), rajoni i Gjilanit me 86 (7,8 %), rajoni i Gjakovës me 83 (7,5 %) dhe rajoni i Pejës me 76 (6,9 %).

HORMUZI NUK DO TË JETË MË SI MË PARË



Fundi i epokës së lundrimit të lirë është një goditje për globalizimin. Por në rajon tashmë po përgatiten rrugë alternative.

Mes shumë paqartësive të marrëveshjes me 14 pika që konsolidon armëpushimin në Gjirin Persik, një element duket si një minë politike e vendosur në fundin e Ngushticës së Hormuzit. Ajo gjendet në pikën e pestë dhe thotë: “Regjimi i Teheranit do të diskutojë me Omanin për të përcaktuar administrimin e ardhshëm të shërbimeve detare në ngushticë (...), në përputhje me të drejtën ndërkombëtare dhe të drejtat sovraane të shteteve bregdetare.”

Kjo formulë i referohet një lëvizjeje që Irani e kishte bërë tashmë në maj, kur vëmendja e vëzhguesve ndërkombëtarë ishte përqendruar kryesisht te çmimi i naftës dhe negociatat në Shtëpinë e Bardhë.

Në atë kohë, Garda Revolucionare iraniane krijoi një institucion të quajtur “Autoriteti i Ngushticës së Gjirit Persik”, me detyrën për të administruar këtë segment detar. Nuk është ende e qartë se çfarë nënkupton konkretisht kjo nismë.

Ajo që është e qartë është se Irani synon të ushtrojë kontroll mbi atë kalim strategjik, përmes të cilit deri në janar kalonte rreth një e pesta e furnizimit botëror me naftë bruto, gaz natyror të lëngshëm, plehra kimike, naftë dhe alumin.

Mohammed Bagher Ghalibaf, kryenegociator i Teheranit dhe president i Parlamentit iranian, e tha hapur: “Ngushtica e Hormuzit nuk do të kthehet më kurrë në gjendjen e mëparshme.” Dhe shtoi: “Natyrsh, do të kërkojmë një tarifë për shërbimet që do të ofrojmë.”

Idëja është që kjo pagesë të mos paraqitet si një taksë formale, por si një kompensim për shërbimet e navigimit ose për mbrojtjen mjedisore të zonës.

Megjithatë, që tani Garda Revolucionare po kërkon që anijet të regjistrohen pranë këtij Autoriteti të Ngushticës dhe të nënshkruajnë një lloj sigurimi, i cili në praktikë do të ishte falas.

Pikërisht këtu ndryshojnë edhe shkëmbimet tregtare të këtyre ditëve. Së pari kalojnë anijet. Nëse përpiqen të kalojnë pa u regjistruar, amerikanët reagojnë duke goditur pozicionet iraniane.

Hormuzi, një zonë e minuar

Është një fushë e minuar, si në kuptimin politik ashtu edhe në atë të mirëfilltë ushtarak. Sidomos sepse, për gjashtëdhjetë ditët e negociatave para sulmit amerikan ndaj Iranit, qarkullimi i anijeve drejt dhe nga Gjiri Persik ishte i lirë. Ndaj, një kontroll i Teheranit dhe vendosja e një tarife do të shndërroheshin në simbolin e humbjes së parimit mbi të cilin Uashingtoni ka mbështetur për dekada politikën e tij: lirinë e lundrimit në ngushticat më strategjike të botës dhe mbajtjen nën kontroll të kostove të tregtisë globale.

Megjithatë, nuk është një lojë e lehtë për Iranin.

Kjo sepse Teherani po përpiqet të bindë në heshtje aleatët e vet në këtë përballje, duke filluar nga Omani, i cili kontrollon bregun jugor të Ngushticës së Hormuzit përgjatë rreth 33 kilometrave. Ditët e fundit qeveria e Muskatit u ka bërë të ditur përfaqësuesve evropianë se Hormuzi nuk do të rikthehet më në gjendjen e mëparshme, sipas burimeve të

cituar nga Bloomberg, pasi anijet në tranzit mund të detyrohen të paguajnë tarifa kalimi.

Po të martën, Sulltanati i Omanit njoftoi zyrtarisht se do të diskutojë me Teheranin mënyrën e administrimit të ujërave të ngushticës dhe kostot përkatëse. Për një shtet të vogël si Omani, pjesëmarrja në të ardhurat që mund të sjellë ky mekanizëm për dekada, të vlerësuara potencialisht në dhjetëra miliarda dollarë në vit, është një mundësi tepër joshëse. Pikërisht sot, Sulltani Haitham bin Tariq do ta diskutojë këtë çështje në Paris me Presidentin francez Emmanuel Macron.

Natyrsh, qeveritë evropiane, vendet kryesore të Gjirit dhe kompanitë më të mëdha globale të transportit detar mbeten fuqimisht kundër çdo tarife mbi Hormuzin.

Një precedent i tillë mund të nxisë kërkesa të ngjashme edhe në pika të tjera strategjike të botës, si Ngushtica e Malakës, ngushtica e Tajvanit apo Ngushtica e Beringut. Në atë rast, globalizimi do të bëhej më i ngadaltë dhe shumë më i kushtueshëm.

Megjithatë, Irani mund të ketë

arritur tashmë atë që synonte.


Madje, rrezikon të ushqejë një perceptim të ekzagjeruar të fuqisë së tij mbi Hormuzin.

Nëse vendos tarifa ose pretendon kontroll mbi ngushticën, vendet e Gjirit do të përshpejtojnë edhe më shumë kërkimin e rrugëve alternative.

Abu Dhabi tashmë po punon për të dyfishuar, në 3.7 milionë fuçi naftë në ditë (deri në fund të vitit 2027), kapacitetin e naftësllësit që transporton naftën drejt porteve jashtë Ngushticës së Hormuzit.

Nga ana e tyre, kompanitë e transportit detar po eksperimentojnë tashmë me transportin e mallrave me kamion deri në portet jashtë Gjirit Persik. Rreziku është që vendosja e një tarife ose pretendimi për kontroll të shndërrohet në një fitore të përkohshme për Iranin.

Këtë e paralajmëron edhe Këshilli Kombëtar i Sigurisë i Iranit, në një analizë të botuar në revistën Foreign Affairs. Mesazhi është i qartë: Nëse lufta duhet të fitohet, Irani nuk mund ta përballojë luksin e humbjes së paqes. / CDS – Bota.al



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN
SEKURIT
PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE
'BUJOËSIA'**
TEL: 045/82 82 82

Zyrtare: Almir Kryeziu vishet kuqezi

TETOVË, 29 QERSHOR - KF Shkëndija ka zyrtarizuar transferimin e sulmuesit anësor Almir Kryeziu, i cili ka nënshkruar kontratë dyvjeçare me klubin kuqezi. 27-vjeçari ka kaluar me sukses testet mjekësore para se të firmoste

marrëveshjen, duke u bërë zyrtarisht futbollisti më i ri i skuadrës nga Tetova.

Pas përfundimit të obligimeve të para mediatike, përfshirë fotografimin zyrtar dhe intervistën e parë si lojtar i Shkëndijës, Kryeziu është nisur

drejt Sllovenisë, ku do t'i bashkohet menjëherë ekipit në fazën përgatitore. Sulmuesi anësor ka qenë një nga lojtarët më të spikatur në elitën e futbollit kosovar, duke tërhequr interesim nga disa klube, përfshirë edhe oferta nga jashtë

vendit. Megjithatë, ai ka zgjedhur projektin sportiv të Shkëndijës dhe fanellën kuqezi. Në klubin tetovar shprehen të kënaqur me arritjen e marrëveshjes dhe i kanë uruar mirëseardhje lojtarit të ri, duke i dëshiruar suksese në fanellën e Shkëndijës.



ADEMI URON FC 2 KORRIKU NË PËRVJETORIN E THEMELIMIT: KLUB ME HISTORI TË VEÇANTË DHE SIMBOL I PËRKUSHTIMIT NDAJ FUTBOLLIT



PRISHTINË, 29 QERSHOR - Presidenti i Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK), Agim Ademi, ka vizituar FC 2 Korriku me rastin e përvjetorit të themelimit të klubit, duke e vlerësuar atë si një klub me histori të veçantë, që mban me krenari emrin e 2 Korrikut 1990, datës së Deklaratës Kushtetuese, një prej momenteve më të rëndësishme në rrugëtimin e Kosovës drejt lirisë dhe pavarësisë. Në një postim në "Facebook", Ademi ka theksuar se FC 2 Korriku, i themeluar në kohë

sfiduese, është shndërruar në simbol të përkushtimit dhe zhvillimit të futbollit, ndërsa sot vazhdon të edukojë dhe promovojë gjenerata të reja në kushte moderne.

Ai ka bërë me dije se ka marrë pjesë edhe në turneun e njomakëve, ku janë mbledhur klube nga të gjitha trojet shqiptare. "Ky aktivitet dëshmon se futbollit i bashkon të rinjtë, krijon miqësi dhe forcon lidhjet mes klubeve tona", ka shkruar Ademi.

Sipas tij, prania e fëmijëve në

fushë rikujton me respekt gjeneratat që luajtën në kushte të vështira, me sakrificë dhe përkushtim, duke e mbajtur gjallë futbollin në periudhat më të rënda të Kosovës. "Falë tyre, sot të rinjtë tanë kanë mundësi shumë më të mira për ta ndërtuar të ardhmen e futbollit", ka shkruar Ademi.

Në fund, presidenti i FFK-së ka uruar FC 2 Korriku për përvjetorin e themelimit, duke i dëshiruar suksese dhe vazhdimësi në misionin për zhvillimin e futbollistëve të rinj.

SUNDERLANDI REFUZOI OFERTËN PREJ 8 MILIONË EUROSH, CHELSEA PËRGATIT OFERTËN E RADHËS PËR GRANIT XHAKËN

LONDËR, 29 QERSHOR - Chelsea nuk ka hequr dorë nga transferimi i Granit Xhakës gjatë kësaj vere, sipas raportimeve të gazetarit Florian Plettenberg. "Blutë" pritet të zhvillojnë një raund të ri bisedimesh me Sunderlandin të hënën, pasi oferta e parë prej 8 milionë

eurosh është refuzuar menjëherë nga klubi anglez.

Sunderlandi ka bërë të qartë, si publikisht ashtu edhe privatisht, se kapiteni i tij nuk është në shitje dhe se nuk ka ndërmend të shqyrtojë oferta të tjera për mesfushorin shqiptar. Megjithatë, Xhaka mbetet i

interesuar për një transferim te "Stamford Bridge", pasi dëshiron të ribashkohet me Xabi Alonson, me të cilin pati sukses gjatë kohës së tij te Bayer Leverkuseni. "Transferimi mbetet i vështirë, por në këtë fazë nuk ka dështuar", ka shkruar Plettenberg në rrjetet sociale,

duke lënë të hapur mundësinë që Chelsea të vazhdojë përpjekjet për ta bindur Sunderlandin.

Ndërkohë, Xhaka mbetet i fokusuar te Kampionati Botëror 2026, ku me Zvicrën ka arritur fazën e eliminimit direkt dhe do të përballlet me Algjerinë.



FIorentina SHFAQ INTERES PËR EDON ZHEGROVËN



TORINO, 29 QERSHOR - Edon Zhegrova mund të largohet nga Juventus gjatë afatit kalimtar veror, me Fiorentinën që është shfaqur si njëra prej skuadrave më të interesuara për transferimin e anësorit. Ylli i Kosovës, i cili mban edhe shtetësinë shqiptare, i është bashkuar Juventusit verën e kaluar nga Lille, me pritshmëri të mëdha, por nuk ka arritur të lërë gjurmën e

pritur në sezonin e tij të parë në Serie A. Sipas gazetës italiane "La Nazione", përmes "CalcioMercato.it", largimi i 27-vjeçarit nga Torino duket gjithnjë e më i mundshëm. Raportohet se Fiorentina po e monitoron nga afër situatën e Zhegrovës dhe së shpejti mund të paraqesë ofertën e parë zyrtare për kartonin e tij. Juventus kishte paguar rreth 15

milione euro për transferimin e kosovarit, ndërsa Zhegrova ka kontratë të vlefshme deri në verën e vitit 2030, me një pagë neto prej 2.5 milionë eurosh në sezon - një shifër që konsiderohet e përbalueshme për Fiorentinën. Ky aspekt financiar shihet si një faktor kyç që mund ta bëjë të realizueshëm transferimin, ndërsa raportimet bëjnë të ditur se klubi

vjollcë është i gatshëm të intensifikojë bisedimet dhe të testojë vendosmërinë e Juventusit në ditët në vijim. Për "Zonjën e Vjetër", shitja e Zhegrovës do të ishte një mundësi për të riformuar repartin ofensiv, ndërsa Fiorentina beson se mund ta rikthejë atë në formën që e bëri një prej lojtarëve më të spikatur të Ligue 1 gjatë periudhës së tij te Lille.

Lewandowski shumë pranë transferimit te Chicago Fire

ÇIKAGO, 29 QERSHOR - Sulmuesi polak Robert Lewandowski është shumë pranë një transferimi të ri në karrierën e tij, pasi pritet të bashkohet me skuadrën amerikane Chicago Fire në MLS. Sipas

raportimeve të Fabrizioo Romano, marrëveshja mes palëve është arritur, ndërsa Lewandowski ka dhënë pëlqimin e tij për t'iu bashkuar klubit pas një vizite që kishte zhvilluar në qytet dhe te

skuadra dy javë më parë.

Transferimi i tij në Chicago Fire pritet të zyrtarizohet këto ditë, ku sulmuesi polak do të nënshkruajë kontratën e re dhe do të nisë një kapitull të ri në karrierën e tij në kampionatin

amerikan MLS. Lewandowski, i njohur si një nga sulmuesit më të mirë të dekadës së fundit në futbollin evropian, pritet të jetë një prej emrave më të mëdhenj që i bashkohet ligës amerikane në vitet e fundit.





KOMPANIA REGJIONALE E UJITJES
REGIONALNA KOMPANIJA ZA KAVLENJE I OVLIVANJE
"Radoniqi-Dukagjini" Sh.A. Kompanija za Narodopravne D.O.
"Radoniqi-Dukagjini" Sh.A.
BULEVARI "11. MART" 10000 PRIZREN
TEL: 045 460 100 FAX: 045 460 101
WWW.KRURADONIQI-DUKAGJINI.COM

Nr Prot. 477 Data 30.06.2026

Në bazë të nenit 8, pika 1 e 2 e Ligjit të Punës të Republikës së Kosovës, nenit 5 dhe 7 të UA 01/2024 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik, si dhe vendimit nr. 476/29.06.2026, KRU Radoniqi-Dukagjini Sh.A, me datë 30/06/2026 shpall këtë:

KONKURS PUBLIK

Për plotësimin e tri pozitave:

- Titulli i punës per poziten 1: Inxhinier i ndërtimtarisë drejtimi hidroteknik ne Njësinë Operative Lugbunar ne Gjakovë**
2: Inxhinier i ndërtimtarisë drejtimi hidroteknik ne Njësinë Operative Xerxe ne Gjakovë
3: Punëtor Fizik

Numri i references: 477

Vendi: Gjakovë

Ndërmarrja : Kompania Regjionale e Ujitjes Radoniqi-Dukagjini Sh.A

Kohëzgjatja e punës: Në kohë të pacaktuar /puna provuese (6) gjashte muaj ne pajtim me Ligjin e Punës.

- **Niveli i pagës:** Sipas Rregullores së brendshme në harmoni me politikat e Kompanisë.

Kompania Regjionale e Ujitjes Radoniqi-Dukagjini Sh.A është Ndërmarrje Publike që në kuadër të veprimtarisë së saj përfshin grumbullimin dhe ofrimin e shërbimit me ujë për ujitjen e tokave bujqësore që shtrihen në perimetrimin e sistemit të ujitjes në tri komunitet në Gjakovë, Rahovec dhe Prizrenit.

Kompania Regjionale e Ujitjes Radoniqi-Dukagjini Sh.A dëshiron që të gjithë kandidatët potencial të jenë persona me integritet të lartë të cilët i plotësojnë kushtet e kualifikimit si dhe plotësojnë kushtet e pavarësisë dhe kanë përvojën e nevojshme profesionale dhe shkollimin e kërkuar për pozitën në fjalë.

Kushtet dhe kualifikimet e kërkuara per pozitën 1 e 2:

- Diplomë universitare në Ndërtimtarë/Hidroteknikë, apo të ngjashme.
- Përvoja e punës: preferohet përvojë e punës në punët e ujitjes, hidroteknikës, bujqësisë ose të ngjashme;
- Shkathtësi në komunikim, planifikim të punës dhe udhëheqje të ekipit;
- Shkathtësi në programeve kompjuterike (Cad, GIS, Office, etj.);
- Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- Të jetë në gjendje të punojë nën presion;
- Aftësi dhe përshtatje në punë ekipore;

Detyrat dhe Përgjegjësitë:

- Përgatit hartimin e planit afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë të Njësisë Punuese;
- Harton propozimin e Planit Vjetor për sistemin e ujitjes dhe objektet e sistemit të caktuar për mirëmbajtje të Njësisë Punuese (NJP) përkatëse;
- Organizon punën për shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e sistemit në kuadër të NJP;
- Kujdeset mbi shfrytëzimin racional të mjeteve të punës;
- Kujdeset që të ketë raporte të mira me fermerët dhe shfrytëzuesit e ujitjes në terrenin të cilin e ka nën mbikëqyrje;
- Kujdeset që të gjithë shfrytëzuesit e ujitjes për ujirje dhe sipërfaqet nën sistemin e ujitjes të jenë të regjistruara si të tilla në evidencat e Ndërmarrjes;
- Kujdeset dhe mban evidencë të sasisë së shpenzuar të ujitjes për ujitje dhe analizon nevojat e shpenzimit në raport me sipërfaqet e ujitura në sipërfaqen që Nj.P. e mbulon;
- Propozon rindarjen e orarit të punës dhe punën më të gjatë se orari i rregullt i punës;
- Propozon kërkesat për material dhe mekanizim të nevojshëm, etj;
- Mbikëqyrë dhe vlerëson punën e secilit të punësuar të Njësisë Punuese dhe mban shënime mbi performancën e secilit;
- Organizon pushimet dhe punët e të punësuarve që ka nën mbikëqyrje;
- Kryen dhe detyra të tjera bazuar në kërkesën e menaxherit, të cilat kërkohen për funksionimin efektiv të ndërmarrjes;
- Për punën e vet i raporton dhe i përgjigjet Menaxherit/ës të Departamentit Teknik.

Kushtet dhe kualifikimet e kërkuara për pozitën: 3

- Përgatitja Shkollore: Shkollim i mesëm ose fillor;
- Aftësi për përmbushjen e detyrave dhe punëve nën presion;
- Aftësi dhe përshtatje në punë ekipore;
- Të ketë aftësi të mira fizike dhe shëndetësore në realizimin e detyrave;

Detyrat dhe Përgjegjësitë:

- Punon në ngarkimin dhe shkarkimin e materialeve të ndryshme, sipas nevojës;
- Punon në gropimin e kanaleve dhe pastrimin, si dhe eliminimin e defekteve;
- Bën pastrimin e defekteve, kanaleve dhe pjesëve të tjera;
- U ndihmon të punësuarve të tjerë sipas nevojës në kuadër të punës;
- Zbaton masat e mbrojtjes në punë dhe masave higjieno-teknike;
- Punon dhe punë të tjera sipas urdhrave të eporit të drejtpërdrejtë;
- Për punën e tij i përgjigjet Kryepunëtorit/ës të Sektorit Teknik;

Procedura për aplikim

Dokumentacioni i nevojshëm:

- Një C.V. e detajuar.
- Kopja e dokumentit identifikues.
- Letër motivimi.
- Dëshmitë e përgatitjes profesionale të noterizuara.
- Dëshmi mbi përvojën në punë, si dhe dëshmi të tjera në bazë të kualifikimit dhe aftësive.
- Referenca nga punëdhënësit paraprak.
- Certifikata nga gjykata kompetente që nuk është subjekt hetimi për kryerjen e veprës penale, nuk është në procedurë penale dhe nuk është i dënuar nga gjykata kompetente për kryerjen e një veprë penale jo më të vjetër se 6 (gjashtë) muaj.
- Aplikacionet mund të tërhiqen në KRU Radoniqi-Dukagjini Sh.A që gjendet në Gjakovë rruga e UÇK-së. Nr. 7, ose në faqen zyrtare të kompanisë: <https://kruradoniqi-dukagjini.com/>

Dokumentacioni i kompletuar dorëzohet vetëm në formën elektronike në e-mail zyrtarë të kompanisë: kruradoniqi-dukagjini@hotmail.com

Konkursi mbetet i hapur pesëmbëdhjetë (15) ditë kalendarike, afati i fundit për aplikim është data 15/07/2026 deri në ora 16:00

Vërejtje: Kandidatet me dokumentacion të pakompletuar, të paplotësuar dhe pas afatit të konkurimit do të refuzohen. Do të kontaktohen vetëm kandidatet të cilët i plotësojnë kushtet e përcaktuara dhe të përfshirë në listën e ngushtë.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- "Fufarma" SH.PK. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. Unik Identifikues: 810047507.

- Armando Brahimi shpall të pavlefshme ID-Kartelën me nr. E-Z-E22\81 të Kolegjit "Biznesi".

- Ermir Kovaçi shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme të lartë të Gjimnazit "Frang Bardhi".

- Florent Binai shpall të pavlefshme dëftesën e sh.m.u. në Arbanë Prizren "Ibrahim Fehmiu".

- "AlfaA rent" LLC. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. Unik Identifikues: 812343557.

- Ndërmarrja e re Deva Uzina e përpunimit të gazrave teknike sh.p.k. Gjakovë shpall të humbur certifikatën e regjistrimit të biznesit me nr. 810812273 të lëshuar nga ARBK.

- Eljesa Beqiri shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12.13 të Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Valentina Sulejmani shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 1.2.3. të shkollës së mesme të mjekësisë "Hysni Zajmi" Gjakovë.

- "Flemingo Kosovo" LLC. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. Unik Identifikues: 810126278.

- Ensar Muriqi shpall të pavlefshme diplomën QK "11 Marsi" Prizren.

- Jusuf Idrizi shpall të pavlefshme 3 dëftesat QK "11 Marsi" Prizren.
- Anita Gashi shpall të pavlefshme dëftesat e kl. VI - IX sh.f.m.u. " Ibrahim Fehmiu" Prizren.

- Kujtim Kamberi shpall të pavlefshme 3 dëftesat dhe diplomën e QK "11 Marsi" Prizren.

- D.P.Z. Drita, Gjakovë shpall të pavlefshme numrin Unik Identifikues 810235037 të lëshuar nga ARBK.

- Betim Idrizi shpall të pavlefshme dëftesën e kl. 11 të sh.m. mjekësisë "Hysni Zajmi" Gjakovë Fizioterapi.

- Nazmije Muhadri shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Gjergj Kastrioti Skenderbeu" Mazdrek.

- Valmir Leniqi shpall të pavlefshme dëftesën e sh.f.m.u. "Hamëz Cena" Damjan Gjakovë nga kl. 1-9.

- Liridon Leniqi shpall të pavlefshme dëftesën e sh.f.m.u. "Hamëz Cena" Damjan Gjakovë nga kl. 1-8.

- "Restorant te Besi" SH.PK. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. Unik Identifikues: 812064575.

Vera Velija shpall të humbur numrin - unik identifikues 811608712 të lëshuar nga ARBK.



Na osnovu člana 8, tačka 1 i 2 Zakona o radu Republike Kosovo, člana 5 i 7 AU 01/2024 o regulisanju postupaka konkurencije u javnom sektoru, kao i Odluke br. 476/29.06.2026, RKN Radoniki-Dukagjini S.A, od 30.06.2026. godine, objavljuje sledeće:

JAVNI KONKURS

Popunjavanje radnih mesta:

- Naziv posla za poziciju 1: Građevinski inženjer, Hidrotehničko odeljenje,
Operativna jedinica Lugbunar u Đakovici
2: Građevinski inženjer, Hidrotehničko odeljenje,
Operativna jedinica Zrze u Đakovici
3: Fizički radnik

Referentni broj: 477

Lokacija: Đakovica

Preduzeće: Regionalna kompanija za navodnjavanje Radoniki-Dukagjini D. D.

Trajanje rada: Određeno vreme sa mogućnošću produženja, probni rad od (6) šest meseci u skladu sa Zakonom o radu.

- Nivo plate za tri pozicije: Prema Internim propisima u skladu sa politikama Kompanije

Regionalno preduzeće za navodnjavanje Radoniki-Dukađini, DD, je javno preduzeće koje, u okviru svoje delatnosti, obuhvata prikupljanje i pružanje usluga vodosnabdevanja za navodnjavanje poljoprivrednog zemljišta koje se prostire unutar perimetra sistema za navodnjavanje u tri opštine: Đakovica, Orahovac i Prizren.

Regionalno preduzeće za navodnjavanje Radoniki-Dukađini, DD, želi da svi potencijalni kandidati budu osobe visokog integriteta koje ispunjavaju kvalifikacione uslove, kao i uslove nezavisnosti, i da poseduju neophodno stručno iskustvo i obrazovanje potrebno za predmetnu poziciju.

Potrebni zahtevi i kvalifikacije za pozicije 1 i 2:

- Univerzitetska diploma građevinarstva/hidrotehnike ili slično.
- Radno iskustvo: iskustvo u navodnjavanju, hidrotehnici, poljoprivredi ili sličnim poslovima je poželjno;
- Komunikacione veštine, planiranje rada i vođenje tima;
- Poznavanje rada na računaru (CAD, GIS, kancelarijski programi, itd.);
- Istraživačke, analitičke, evaluacione veštine i formulisanje preporuka i stručnih saveta;
- Sposobnost za rad pod pritiskom;
- Sposobnost i prilagodljivost u timskom radu;

Dužnosti i odgovornosti:

- Priprema nacrt kratkoročnog, srednjoročnog i dugoročnog plana Radne jedinice;
- Izrađuje predlog Godišnjeg plana za sistem za navodnjavanje i objekte sistema namenjene za održavanje odgovarajuće Radne jedinice (RJ);;
- Organizuje rad na korišćenju i održavanju sistema u okviru RJ;
- Brine o racionalnom korišćenju radnih alata;
- Brine o dobrim odnosima sa poljoprivrednicima i korisnicima vode na području pod njegovim nadzorom;
- Brine da svi korisnici vode za navodnjavanje i površine pod sistemom za navodnjavanje budu registrovani kao takvi u evidenciji Preduzeća;
- Vodi evidenciju o količini vode utrošene za navodnjavanje i analizira potrebe rashoda u odnosu na navodnjavane površine na području koje RJ pokriva;
- Predlaže preraspodelu radnog vremena i rad duže od redovnog radnog vremena;
- Predlaže zahteve za potreban materijal i mehanizaciju itd.;
- Nadgleda i procenjuje rad svakog zaposlenog u Radnoj jedinici i vodi evidenciju o učinku svakog od njih;
- Organizuje odmore i rad zaposlenih pod svojim nadzorom;
- Obavlja i druge zadatke na zahtev rukovodioca tehničkog odeljenja, a koji su potrebni za efikasno funkcionisanje preduzeća;
- Izveštava i odgovara za svoj rad rukovodiocu tehničkog odeljenja

Potrebni zahtevi i kvalifikacije za pozicije 3:

- Obrazovna sprema: Srednje ili osnovno obrazovanje;
- Sposobnost za obavljanje zadataka i rad pod pritiskom;
- Sposobnost i prilagodljivost timskom radu;
- Posedovanje dobrih fizičkih i zdravstvenih sposobnosti u obavljanju zadataka;

Dužnosti i odgovornosti:

- Radi na utovaru i istovaru raznih materijala, po potrebi;
- Radi na kopanju kanala i čišćenju, kao i otklanjanju nedostataka;
- Čisti nedostatke, kanale i druge delove;
- Pomaže drugim zaposlenima po potrebi u okviru posla;
- Sprovodi mere bezbednosti i higijene na radu;
- Obavlja i druge poslove po nalogu neposrednog pretpostavljenog;
- Odgovara za svoj rad poslovođi Tehničkog sektora;

Postupak prijave:

- Potrebna dokumentacija:
- Detaljna biografija (CV).
- Kopija identifikacionog dokumenta.
- Motivaciono pismo.
- Overeni dokaz o stručnoj obuci.
- Dokaz o radnom iskustvu, kao i drugi dokazi zasnovani na kvalifikacijama i veštinama.
- Preporuke prethodnih poslodavaca.
- Uverenje nadležnog suda da nije predmet istrage za počinjeno krivično delo, da nije u krivičnom postupku i da nije osuđivan od strane nadležnog suda za počinjeno krivično delo, ne starije od 6 (šest) meseci.
- Prijave se mogu podneti u KRU Radoniki-Dukagjini Sh.A koja se nalazi u Đakovici, ulica UÇK br. 7, ili na zvaničnoj veb stranici kompanije: <https://kruradoniki-dukagjini.com/>

Popunjena dokumentacija se dostavlja isključivo u elektronskom obliku na zvaničnu imejl adresu kompanije: kruradoniki-dukagjini@hotmail.com

Konkurs ostaje otvoren petnaesti (15) kalendarskih dana, rok za prijavu je 15.07.2026. do 16:00 časova.

Napomena: Kandidati sa nepotpunom dokumentacijom, nepotpune prijave i prijave podnete nakon isteka roka za konkurs biće odbijeni. Kontaktiraće se samo kandidati koji ispunjavaju navedene uslove i koji su uvršteni u uži izbor.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "US IMPORTS" SH.P.K. me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 812065036 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "US IMPORTS" D.O.O. Pristina donelo odluku o prestani rada sa nrb. 812065036 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability "US IMPORTS" L.L.C. with headquarters Pristina, has come to the decision to quit its business: 812065036 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA

1992







ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

